



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 597 Prot.

Tiranë, më 20 / 05 / 2020

**V E N D I M**

**Nr. 50 , Datë 20 / 05 / 2020**

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbështetur në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”<sup>1</sup>, mori në shqyrtim ankesën me nr.32, datë 11.05.2020, të Sindikatës Kombëtare të Qendrave të Kontaktit “Solidariteti”, si përfaqësuese e G. M, kundër Kompanisë Assist sh.p.k, me objekt pretendimin e diskriminimit për “*çdo shkak tjetër*”<sup>2</sup>.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>3</sup>,

**KONSTATOI:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sindikata Kombëtare e Qendrave të Kontaktit “Solidariteti”<sup>4</sup>, si përfaqësuese e G. M, parashtron në ankesën e sjellë pranë KMD, se: “*Rasti i G. M përbën një precedent shumë problematik në përpjekjet e shoqërisë tonë, në këtë rast të sindikatave të reja, për vetëdijësimin e punëtorëve për të drejtat e tyre në punë dhe për lirinë e shprehjes e të organizimit sindikal*”. Lidhur me rastin e G.M, Sindikata shprehet se, me datë 14.04.2020 asaj i është dhënë masa disiplinore

<sup>1</sup> Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën LMD.

<sup>2</sup> Tek ky shkak është referuar fakti se G.M si anëtare e Sindikatës Kombëtare të Qendrave të Kontaktit “Solidariteti” ka kundërshtuar vazhdimisht shkeljet dhe vendimet e padrejta të Kompanisë.

<sup>3</sup> Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KMD.

<sup>4</sup> Në vijim të vendimit do t’i referohemi si: Sindikata.

“Paralajmërim për largim nga puna” për shkelje të disiplinës dhe kushteve të Kontratës së Punës, nga ana e Kompanisë Assist sh.p.k, duke cituar se: *“Me fillimin e pandemisë dhe me mbylljen e të gjitha aktiviteteve ekonomike, në datën 13.03.2020 u krijua një paqartësi e madhe rreth mënyrës së vazhdimit të punës për punëtorët e sektorit Call Center dhe disa nga punëtorët e kompanisë Assist sh.p.k morën kompjuterat në shtëpi për t’iu përgjigjur kërkesave të punëdhënësit. G .M, pas disa problemeve shumë afatshkurtra me qasjen në internet, të cilat ishin zgjidhur brenda pak orësh, njoftoi Kompaninë se më datë 23.03.2020 mund të vonohej në fillimin e punës. Në mënyrë të menjëhershme, pa asnjë mirëkuptim apo sqarim të mëtejshëm dhe pa asnjë tolerancë, asaj i kërkohet të kthejë kompjuterin në Kompani. G. M nuk arriti ta përmbushë këtë kërkesë sepse në atë kohë nuk lejohej lëvizja nëpër rrugët e Tiranës dhe për më tepër nuk kishte as mundësi transporti. Më datë 07.04.2020, ditën kur G.M rifilloi punën, Kompania e ftoi atë në një takim për t’i komunikuar masën disiplinore “Paralajmërim për largim nga puna”.*

Lidhur me këtë situatë, Sindikata ka pretenduar se Kompania ka diskriminuar G. M, për faktin se, mes shumë punëtorëve të cilët nuk janë paraqitur në punë për të njëjtën periudhë për të cilën ajo mori masën disiplinore nga Kompania, vetëm ajo është ndëshkuar me masë disiplinore me shkrim, masë e cila është përshkallëzuar me largimin e saj përfundimtar nga puna, me datë 06.05.2020. Nga subjekti ankues pretendohet se ky fakt ka ndodhur për shkak se ajo është anëtare e Sindikatës dhe vazhdimisht ka ngritur zërin ndaj masave dhe vendimeve të padrejta të Kompanisë.

Në përfundim të ankesës, subjekti ankues kërkon nga Komisioneri të marrë masa për ndreqjen e pasojave të ardhura si shkak i diskriminimit të G. M nga ana e Kompanisë Assist sh.p.k.

## **II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:**

Ligji nr.10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, ofron mbrojtje nga diskriminimi. Në nenin 1 të tij përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Bazuar në deklaratimet e depozituara nga subjekti ankues, si dhe dokumentacionin bashkëlidhur, Komisioneri, konstaton se:

Mbështetur në dispozitat e ligjit 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” dhe në kërkesat e përcaktuara në formularin e aplikimit, në rastin kur ankesa paraqitet nga një organizatë me interesa legjitime, asaj duhet t’i bashkëlidhet kopja e vendimit të gjykatës për krijimin e organizatës, kopja e statutit të organizatës, kopja e kartës së identitetit ose akti i prokurës së posaçme, për të përfaqësuar personin ose grupin e personave.

Në vijim të korrespondencës zyrtare me KMD-në rezulton se janë paraqitur këto dokumente:

- Kopje e Vendimit nr.12, datë 15.07.2019 i Gjykatës së Rrethit Tiranë, për regjistrimin e Sindikatës Kombëtare të Qendrave të Kontaktit “Solidariteti”, me objekt veprimtarie përfaqësimit dhe mbrojtjen e të drejtave dhe interesave ekonomike, profesionale dhe shoqërore të të gjithë anëtarëve të sindikatës të cilët janë punëmarrësit e sektorit të qendrave të kontaktit (call-center).
- Kopje të Akt-Themelimit të Sindikatës Kombëtare të Qendrave të Kontaktit “Solidariteti”, ku *inter alia* janë përcaktuar edhe: Struktura e Sindikatës, Asmbleja e Përgjithshme, Bordi Drejtues, i përbërë nga 9 anëtarë, dhe Lista e themeluesve, e përbërë prej 30 anëtarësh.
- Kopje e Statutit të Sindikatës Kombëtare të Qendrave të Kontaktit “Solidariteti”, ku në Kreun II “Anëtarësimi në Sindikatë”, citohen nominalisht të gjithë anëtarët themelues të saj, gjithsej 29 anëtarë.

Pas verifikimit të dokumentacionit të sjellë pranë KMD-së, Komisioneri vëren se:

Së pari, referuar Vendimit nr.12, datë 15.07.2019 i Gjykatës së Rrethit Tiranë, për regjistrimin e Sindikatës Kombëtare të Qendrave të Kontaktit “Solidariteti”, konstatohet se objekti i veprimtarisë së kësaj Sindikate është pikërisht përfaqësimi dhe mbrojtja e të drejtave dhe interesave ekonomike, profesionale dhe shoqërore i të gjithë anëtarëve të sindikatës të cilët janë punëmarrësit e sektorit të qendrave të kontaktit (call-center), gjë që do ta legjitimonte “*locus standi*” Sindikatën për të paraqitur ankesë në emër të subjektit ankues për çdo pretendim për diskriminim nga punëdhënësi, për shkak të anëtarësisë në të. Po ashtu, bazuar në pikën 2, të nenit 33 të LMD, ku përcaktohet se: “*Organizata me interesa legjitime paraqet prokurë të posame për të përfaqësuar personin ose grupin e personave*”, Sindikata duhet të paraqiste një akt përfaqësimi, i cili do të shprehte vullnetin e ankueses për përfaqësimin e saj para KMD.

Së dyti, referuar Aktit të Themelimit dhe Statutit të Sindikatës Kombëtare të Qendrave të Kontaktit “Solidariteti”, dhe konkretisht listave emerore të anëtarëve të Saj, të sjella pranë KMD-

së<sup>5</sup>, konstatohet se, subjekti ankues nuk figuron të jetë e anëtarësuar pranë kësaj Sindikate në cilësinë e anëtares apo ndonjë pozicion tjetër.

Së treti, subjekti ankues duke mos provuar anëtarësinë e saj në këtë Sindikatë nuk arrin të provojë as shkakun për të cilin ka pretenduar se ka kundërshtuar shkeljet dhe vendimet e punëdhënësit, në cilësinë e anëtares së kësaj Sindikate.

Referuar nenit 33 pika 4/ç të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” i cili citon se “Ankesa nuk pranohet nëse është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Pra, konkludojmë se nuk plotësohen kriteret ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Sa i takon pretendimit të subjektit ankues për trajtim të pabarabartë me punonjësit e tjerë të Kompanisë të ndodhur në kushte të njëjta me të, nga ana e punëdhënësit, Komisioneri sqaron se një pretendim i tillë nuk mund të merret në shqyrtim, përse kohë subjekti ankues nuk arrin të provojë dhe dokumentojë së pari, shkakun, si pasojë e të cilit pretendon të ketë ardhur dhe trajtimi i tij i pabarabartë dhe së dyti, për faktin se Sindikata nuk legjitimohet të përfaqësojë G. M ligjërisht përpara KMD, për shkak se ajo nuk është anëtare e Saj.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se “viktima” e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme, pikërisht për shkak të një karakteristike të tij që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenet 3, 7, pika 1, neni 32, pika 1, gërma b), si dhe nënenin 33, pika 4, gërma ç), të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

---

<sup>5</sup> H.L, T.R, K.K, S.H, H.L, A.H, F.S, E.SH, H.B, B.D, M.Z, I.B, M.M, A.R, B.M, F.B, F.B, I.I, J.H, O.GJ, D.M, G.M, F.H, T.M, I.S, A.H...

## **V E N D O S I :**

1. Mospranimin e ankesës së paraqitur nga ana e Sindikatës Kombëtare të Qendrave të Kontaktit “Solidariteti”, si përfaqësuese e G. M; pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga Ligji nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

**KOMISIONER**

**Robert GAJDA**

Fusha : Punësim

Shkaku: Përkatësia në një grup të veçantë “çdo shkak tjetër”